



USHTRIA



Viti i 74-të i botimit Nr. 5 (827703)

Botim Qendror i Ministrisë së Mbrojtjes

E premte, 29 Janar 2021

Ministri Peleshi:



Baza Ajrore e Kuçovës, realizimi i projektit-afati i fundit viti 2023

Dy vite më parë Aleanca e Atlantikut të Veriut miratoi vendimin për të ndërtuar në Shqipëri bazën e parë ajrore të Ballkanit Perëndimor. Ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi, tha, më 26 janar 2021, në intervistën për RTSH, se projekti i bazës ajrore të Kuçovës po jetësohet dhe do të jetë gati në fund të muajit

tetor. "Baza e Kuçovës është një projekt që tani po jetësohet. Deri në fund të marsit do të përfundojë prokurimi nga njësi prokuruese e NATO-s dhe do të kontraktohet kompania apo kompanitë që do të zbatojnë projektin. Është një projekt "projekto dhe ndërto", i cili parashikohet që deri nga...

» faqe 2

Ministri Peleshi takon ambasadoren franceze znj. Elisabeth Barsacq

Ministri i Mbrojtjes Peleshi: Mirënjohje Francës për modernizimin e Forcave të Armatosura të Shqipërisë

Ministri i Mbrojtjes z. Niko Peleshi ka zhvilluar, një takim miqësor me ambasadoren franceze në Shqipëri, Znj. Elisabeth Barsacq » faqe 3



35-VITE PJESE E FORCAVE TË ARMATOSURA

Ndahet nga jeta dekani i AFA, Prof. Dr. Kolonel Agim Sula



» faqe 6

Ministri Peleshi në zonat e përmbytura në Durrës

FA janë në terren, por duhen nxjerrë mësimet

Lumi Erzen është tërhequr në shtratin e tij, por shumë shtëpi mbeten ende nën ujë në njësinë administrative Katund i Ri në bashkinë e Durrësit. Për të parë situatën nga afër, ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi ishte vetë ditën e mërkurë, më 27 janar 2021, në zonën e përmbytur, ku shoqërohej nga ministrja e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural Milva Ekonomi dhe kryetarja e bashkisë së Durrësit Emiriana Sako. Ministri Peleshi bisedoi me...



» faqe 2

Qendra e Arsimit Profesional të Nënoficerëve

Fillon kursi i 47-të Bazë i Nënoficerit

Një tjetër kurs Bazë fillon në Qendrën e Arsimit Profesional të Nënoficerëve. Në datën 25.01.2020 u hap kursi 47-të Bazë i Nënoficerit, i përbërë nga 36 kursantë ku 3 prej tyre femra. Kursi Bazë i Nënoficerit (Faza I), zhvillohet në QAPN gjatë një harku kohor 8-javor dhe ka si qëllim zhvillimin e elementeve themelore të personalitetit të tetarit si drejtues në rol të komandantit të skuadrës dhe detyra të njësura me të, edukimin dhe përgjegjësinë ndaj detyrës... » faqe 5



Shtetet e Bashkuara të Amerikës Gjenerali afro-amerikan Lloyd Austin, Sekretari i Mbrojtjes i SHBA-së

» faqe 9

BASHKËPUNIM PËR KËRKIM-SHPËTIMIN

QKKSH, strukturë kryesore e menaxhimit të operacioneve të kërkim-shpëtimit

VAIT GOLIKJA

» faqe 4

KOMANDA MBËSHTETËSE

Me mjete speciale në krye të detyrës nga Tropoja në Brataj të Vlorës

» faqe 5

Ministri Peleshi:

Dy vite më parë Aleanca e Atlantikut të Veriut miratoi vendimin për të ndërtuar në Shqipëri bazën e parë ajrore të Ballkanit Perëndimor. Ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi, tha, më 26 janar 2021, në intervistën për RTSH, se projekti i bazës ajrore të Kuçovës po jetësohet dhe do të jetë gati në fund të muajit tetor.

“Baza e Kuçovës është një projekt që tani po jetësohet. Deri në fund të marsit do të përfundojë prokurimi nga njësia prokurore e NATO-s dhe do të kontraktohet kompania apo kompanitë që do të zbatojnë projektin. Është një projekt “projekto dhe ndërto”, i cili parashikohet që deri nga fundi i tetorit të këtij viti ketë përfunduar dhe të nisë me shpresë implementimi i tij. Realizimi i projektit ka si afat të synuar fundin e vitit 2023. Nuk është më një ambicie.”- tha Peleshi.

Kësaj i ka paraprirë edhe baza ligjore. Kështu, më 22 tetor 2020, Kuvendi i Shqipërisë ka miratuar projektligjin “Marrëveshja për mbështetje teknike ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Agjencisë së Mbështetjes dhe Prokurimit të NATO-s për realizimin e Projekteve të Kuçovës, të financuara nga Programi i Investimeve të NATO-s për Sigurinë, vitet 2019-2022”

Kjo bazë, ku do të investohen 50 milionë euro, e vendos Shqipërinë në hartën e interesave strategjike të NATO-s. Vendi merr një rëndësi strategjike që nuk e ka pasur më prej shumë e shumë dekadash. Ky është jo vetëm investimi më i madh, por edhe e vetmja bazë ajrore e NATO-s në rajonin tonë. Në terma ushtarakë, Baza e Kuçovës do të jetë një Bazë Taktike e Dislokueshme, që do të ketë të gjithë infrastrukturën dhe kapacitetet e nevojshme për të mbështetur 24 orë në 7 ditë të javës, misionet e NATO-s, qofshin këto misione stërvitore në kohë paqeje, apo misione luftarake në kohë krize. Më konkretisht baza do të mbështesë dislokimin e 6 avionëve luftarakë taktikë dhe të avionëve të transportit. Funksionimi i Bazës së Kuçovës do të ketë një ndikim të rëndësishëm për sa i përket modernizimit dhe fuqizimit të Forcave Ajrore Shqiptare.

Interesi i kompanive të huaja ka qënë i lartë. Agjencia e NATO-s për Mbështetje dhe Prokurime, e cila realizon procedurat tenderuese, prezantoi në fillim të muajit dhjetor 2020, procedurat dhe dokumentacionin e nevojshëm, që duhet të përmbushin firmat kontraktore, përpara se të aplikojnë për kryerjen e punimeve për modernizimin e Bazës së Kuçovës dhe kthimin e saj në Bazë Ajrore Taktike të NATO-s. Në këtë Konferencë morën pjesë pjesë 60 përfaqësues të kontraktorëve potencialë nga 36 kompani të ndryshme, nga të cilat 22 të huaja dhe 14 shqiptare.

Për rëndësinë e Bazës Ajrore të Kuçovës është shprehur edhe shtypi ndërkombëtar. Më 5 gusht 2018, gazeta prestigjioze amerikane “Washington Post”, i ka dedikuar një artikull bazës ajrore që pritet të ndërtohet. “Baza ajrore ka qënë atje për dekada të tëra. Baza do t'i shërbejë Shqipërisë dhe

Baza Ajrore e Kuçovës, realizimi i projektit-afati i fundit viti 2023

Deri në fund të marsit do të përfundojë prokurimi nga Agjencia e NATO-s për Mbështetje dhe Prokurime



gjithashtu do të mbështesë operacionet e furnizimit me ajër të NATO-s, mbështetjen e logjistikës, policinë ajrore dhe stërvitjet. Kryeministri tha gjithashtu se zyrtarët po diskutojnë me Shtetet Bashkuara mbi modernizimin e mëtejshëm të kapaciteteve ajrore shq-

iptare”, shkruhet në artikullin e “Washington Post”. Baza Ajrore e Taktike e Kuçovës, do të shërbejë për trajnimin e personelit për operacione në një spektër të gjerë luftarak të imbarkim-zbarkimit, kërkim-shpëtimit, emergjencave civile dhe atyre humanitare.



MINISTRI PELESHI NË ZONAT E PËRMBYTURA NË DURRËS

FA janë në terren, por duhen nxjerrë mësimet

Lumi Erzen është tërhequr në shtratin e tij, por shumë shtëpi mbeten ende nën ujë në njësine administrative Katund i Ri në bashkinë e Durrësit. Për të parë situatën nga afër, ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi ishte vetë ditën e mërkurë, më 27 janar 2021, në zonën e përmbytur, ku shoqërohej nga ministrja e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural Milva Ekonomi dhe kryetarja e bashkisë së Durrësit Emiriana Sako. Ministri Peleshi bisedoi me banorët për situatën e krijuar dhe përgjegjësitë që duhet të marrë gjithsecili që këto ngjarje të mos përsëriten më. Zoti ministër takoi edhe efektivët e Forcave të Armatosura, të cilët prej 3 ditësh kanë ndihmuar në evakuimin e disa familjeve dhe transportin e tyre.

Ministri i Mbrojtjes konstatoi përmirësimin e situatës, siguroi gatishmërinë e FA dhe vuri theksin te mësimet që duhen nxjerrë me qëllim që reshjet e dendura dhe dalja nga shtrati i lumit Erzen të kenë sa më pak pasoja. “Le të themi e kemi kaluar pikun, situata sot është duke u përmirësuar, reshjet kanë mbaruar, uji po tërhiqet por ka ende familje nën ujë. Unë dua të falënderoj forcat tona të ushtrisë që kanë qënë në gatishmëri që ditën e parë, kanë evakuuar disa familje që janë strehuar në Konvalishencë, një pjesë tjetër të familjarët e tyre, një pjesë që nuk kanë pranuar të dalin, por që nuk kanë qënë në rrezik, sepse kur ka rrezik pranon apo nuk pranon familja evakuimi është i detyruar. Do vazhdojmë të jemi këtu në gatishmëri, ndonëse pritet që dy ditët në vazhdim të ketë mot të mirë. Jemi të pajisur, kemi mjete kalueshmërie të lartë, kemi mjete të vogla lundruese, gjeneratorë dhe



gjithçka tjetër që nevojitet, forca njerëzore, forcat e ushtrisë. Duhet thënë që, kur ka raste të tilla duhet të nxjerrim dhe mësimet. Emergjencia kërkon një reagim multiinstitucional dhe të gjithë shoqërisë. Ajo që shohim këtu fillon nga zënia dhe bllokimi i kanaleve, shkarkimeve nga dinamika informale e ndërtimeve në vite, të cilës tani nuk i kthehemi më dot pas. Madje e kemi përballur me shumë guxim, me legalizime. Këtu procesi legalizimeve ka ecur mirë. Bashkë me legalizimin duhet të kemi vëmendje ndaj urbanizimit. Ne marrim detyra tona, komuniteti duhet të marrë detyrat e veta, kemi patur edhe debate me disa banorë, nuk mund t'i kërkojmë llogari bashkisë kur kanalin shkarkues e bllokun për të bërë një copë rrugë.” - u shpreh ai.

Ministrja e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural Milva Ekonomi kërkoi bashkëpunim nga banorët e zonës

për të liruar dhe zhblokuar kanalet e niveleve të treta. Kryetarja e bashkisë së Durrësit Emiriana Sako falënderoi Forcat e Armatosura për angazhimin në terren dhe njoftoi se me përmirësimin e situatës do të nisë edhe vlerësimi i dëmeve. Gjatë ditëve të fundit, Forcat e Armatosura kanë evakuuar disa familje në Katundin e Ri, një pjesë prej të cilave janë strehuar në Konvalishencë e Durrësit. Në Shkodër vijon prej tre javësh transporti i banorëve të Obotit, ndërkohë që ditën e djeshme janë evakuuar edhe disa krerë bagëti.

Gjithashtu, efektivët e FA me katër pompa të fuqishme thithëse, po ndihmojnë për shkarkimin e rezervuarit në fshatin Plan të bashkisë Tropojë. Nga ana tjetër, FA është e angazhuar edhe në shpërndarjen e pakove ushqimore nga Rezervat e Shtetit për banorët e prekur nga përmbytjet.

Ministri Peleshi takon ambasadoren franceze znj.Elisabeth Barsacq

Ministri i Mbrojtjes Peleshi: Mirënjohje Francës për modernizimin e Forcave të Armatosura të Shqipërisë

Ministri i Mbrojtjes z.Niko Peleshi ka zhvilluar, një takim miqësor me ambasadoren franceze në Shqipëri, Znj.Elisabeth Barsacq

Ministri i Mbrojtjes z.Niko Peleshi ka zhvilluar më 19 janar 2021, një takim miqësor me ambasadoren franceze në Shqipëri, Znj. Elisabeth Barsacq. “Mirënjohje për mbështetjen e vazhdueshme në modernizimin dhe edukimin e Forcave të Armatosura”, shkruan ministri Peleshi, në facebook.

Franca ka luajtur rol të rëndësishëm në modernizimin e Forcave Ajrore Shqiptare. Një moment i vecantë është pajisja e Forcave Ajrore Shqiptare me helikopterin tip “Cougar” në versionin SAR, MEDEVAC dhe Transport Trupash. Marrëveshja, e cila konsistonte në blerjen e 5 helikopterëve transportues nga kompania franceze “Eurocopter”, u firmos nga qeveria shqiptare në vitin 2009 dhe në vitin 2012 ka mbrtur në Rinas helikopteri i parë “Cougar” për të vazhduar me të tjerë. Në zbatim të kontratës për blerjen e helikopterëve modernë e shumëfunksionalë një zë i veçantë ishte edhe trajnimi i pilotëve dhe teknikëve shqiptarë që do të përdorin këtë teknikë.

Duke folur për angazhimet e Francës në mbështetje të Shqipërisë, ambasadorja franceze, Znj.Elisabeth Barsacq, deklaroi në nëntor 2020 se: “Do të bëj ç’është e mundur që Shqipëria një ditë të jetë anëtare e BE-së. Dhe kjo është fare normale sepse Shqipëria është një vend europian. Ky është një proces pune i cili po zhvillohet dhe Shqipëria i ka të gjitha mundësitë që një ditë të jetë anëtare e BE-së”.

Ambasadorja Elisabeth Barsacq ka pak muaj në vendin tonë. Ajo ka dorëzuar më 27 tetor 2020 letrat kreden-



cialë pranë Presidentit të Republikës së Shqipërisë, z.Ilir Meta. Po kush është Elisabeth Barsacq, Ambasadorja e Francës në Shqipëri?

Elisabeth Barsacq është formuar si specialiste për Europën lindore

dhe qendrore. Ajo është diplomuar në Institutin e studimeve politike të Parisit, diplomuar në studime të thelluara, ka diplomën e lartë nga Instituti kombëtar i gjuhëve dhe qytetërimeve lindore. Ajo ka punuar si diplomate në

Poloni, Hungari, Turqi, Rusi dhe në Mongoli, por edhe si Përfaqësuese e Përhershme e Francës pranë Organizatës Detare Ndërkombëtare. Gjatë viteve të fundit, ajo ka qenë Konsulle e Përgjithshme në Shën-Petersburg,

etj. Është ministre e plotfuqishme e klasit të parë. Ka marrë titullin Kalorëse e Legjionit të Nderit, Oficer e Urdhrit Kombëtar të Meritës, Medalje Nderi e Punëve të Jashtme (bronz).

“Do të bëj ç’është e mundur që Shqipëria një ditë të jetë anëtare e BE-së. Dhe kjo është fare normale sepse Shqipëria është një vend europian. Ky është një proces pune i cili po zhvillohet dhe Shqipëria i ka të gjitha mundësitë që një ditë të jetë anëtare e BE-së”.

MINISTRI PELESHI NË KONVALESHENCË, DURRËS

Mjete dhe pako ushqimore nga rezervat e shtetit aty ku ka nevojë



Ministri i Mbrojtjes, Niko Peleshi deklaroi, të martën më 26 janar 2021, se do vazhdojë mbështetja e shtabeve të bashkive që kanë probleme me përmbytjet për shkak të reshjeve të dendura me të gjitha mjetet. Ministri Peleshi ishte te Konvaleshenca në Durrës ku janë strehuar disa nga familjet e evakuuara. Në një prononcim për mediat, Peleshi tha se disa trupa nga Forcat e Armatosura ndodhen në mbështetje të Emergjencave në Sukth, Katundin e Ri në Shijak. “Fatmirësisht janë bërë në kohë evakuimet. Në fakt disa familje nuk kanë pranuar të evakohen, por duhet ta bëjnë patjetër sa herë marrin paralajmërime nga shtabet e bashkisë nga Shtabet e Emergjencave”, -vijoi Peleshi.

Ministri i Mbrojtjes theksoi se “jemi të gatshëm t’u gjendemi kujtdo qoftë për evakuime, apo për të shpëtuar prodhimet e ndryshme bujqësore apo gjënë e gjallë. Kemi disa qindra hektarë nën ujë, por lajmi i mirë është se reshjet kanë pushuar dhe nuk parashikohet të ketë reshje me intensitet të lartë në ditën në vazhdim”.

“Së bashku me shefin e Shtabit të Përgjithshëm, me drejtorin e Emergjencave Civile jemi në gatishmëri dhe në mbështetje nga veriu në jug. Në Tropojë kemi një situatë emergjente me një rezervuar, kemi dërguar katër pompa që në bashkëpunim me Ministrinë e Bujqësisë dhe pushtetin lokal do të punojmë për të shmangur ndonjë situatë emergjente të mundshme. Kemi në Shkodër në Obot, në njësinë administrative Ana e Malit. Aty situata është më e rënduar pasi u bënë mbi 10 ditë që ka prezencë uji. Kemi çuar mjete të tjera të kalueshmërisë së lartë për të kryer lëvizjen, transportin e njerëzve. Edhe në Lezhë kemi toka të përmbytura por siç e thashë situata do të

jetë më e mirë, pasi do të ketë tërheqje të përmbytjes dhe për pak ditë do shkojmë drejt normalizimit”, -tha ai.

Po ashtu, Peleshi theksoi se ne do të vazhdojmë të mbështesim të gjitha shtabet e bashkive, të prefekturave me Forcat tona të Armatosura, me mjete dhe pako ushqimore nga rezervat e shtetit kudo që do ketë nevojë. “Po e shfrytëzoj këtë moment për t’iu kërkuar edhe kryetarëve të bashkive që janë në emergjencë edhe Prefektëve të mos ngurrojnë të na kontaktojnë në kohë, sepse i kemi gati, nuk na ka zënë të papërgatitur, por të përgatitur, edhe në këtë valë përmbytjesh”, -tha Peleshi.

“Ministria e Mbrojtjes ka angazhuar në terren mbi 445 efektivë të forcave të armatosura, për të përballuar emergjencat civile për shkak të motit të keq. Angazhimi i ushtrisë në terren gjatë këtyre ditëve ka qenë i domosdoshëm, pasi pushteti vendor nuk ka marrë masat e duhura. Tani pse duhet të hyjë gjithmonë ushtria të hapë rrugët?! Bashkitë duhet të tregohen pak më të zgjuara në mirëmbajtjen e rrugëve. Nuk duhet të presin sa të bllokohet rruga nga bora dhe pastaj të thërrasin ushtrinë me buldozerë që të pastrojë dëborën, por duhet t’i paraprijnë me kripë dhe me gjithë ato materialet e nevojshme. Kemi shumë punë për të bërë për ta ndryshuar këtë sjellje, për të planifikuar”, -ka deklaruar ministri Peleshi në intervistën për RTSH.

Bashkëpunim për kërkim-shpëtimin

VAIT GOLIKJA
Specialist për Operacionet SAR

Direktiva e Mbrojtjes 2021: Të forcohet roli i Qendrës Kombëtare të Kërkim-Shpëtimit (QKKSH) si struktura kryesore e menaxhimit të operacioneve të kërkim-shpëtimit nëpërmjet rritjes së bashkëpunimit dhe ndërveprimit me institucionet brenda dhe jashtë vendit në përputhje me kërkesat e Planit Kombëtar të Kërkim-Shpëtimit.

Udhëzimi i SHSHPPFA nr 01, datë 1.11.2021: Gjatë vitit 2021, të planëzohet stërvitje për rritjen e aftësive operacionale të strukturave prioritare operacionale dhe mbështetëse, strukturave të cilat mund të angazhohen në operacionet aktuale kombëtare (Kërkim - Shpëtim; Emergjencat Civile/ Fatqeqësi Natyrore...)

Në zbatim të Planit të Koordinimit dhe Bashkëpunimit të QKKSH me strukturat e FA-së, institucionet shtetërore, pushtetin vendor dhe entet private për kërkim-shpëtim, një ekip i QKKSH-së, i kryesuar nga kolonel Fiqiri Hoxha, me detyrë kryetar i QKKSH-së, zhvilluan një aktivitet koordinimi dhe bashkëpunimi në fushën e kërkim-shpëtimit me Forcën Detare, QNOD, Drejtorinë e Përgjithshme Detare dhe Policinë Kufitare e të Migracionit në Durrës.

Qëllimi i aktivitetit ishte bashkëpunimi dhe koordinimi me strukturat ushtarake, entet shtetërore dhe ato private, të cilat disponojnë kapacitete SAR, njohja e përgjegjësisë dhe detyrimeve nga ana e tyre, si dhe marrja e masave për përmirësimin e bashkëpunimit për përdorimin e strukturave operacionale të përbashkëta në përgjigje të situatave dhe zhvillimin e operacioneve SAR.

Në kuadër të aktivitetit u zhvilluan 2 takime, në ambientet e KFD-së dhe QNOD-së. Në KFD ekipi i QKKSH-së u takua me Komandantin e FD-së, general brigade Ilir Xhebexhia dhe shtabin e KFD-së, ndërsa në QNOD ekipi u takua me n/drejtorin e QNOD-së, zotin Petrit Boduni, përfaqësuesin e Drejtorisë së Përgjithshme Detare Durrës zotin Tomor Harizi, përfaqësuesit e Policisë Kufitare dhe Migracionit, zotërinjtë, Drejtues Ndue Doçi, drejtor i Drejtorisë Vendore për Kufirin dhe Migracionin Durrës si dhe Kryekomisar Kastriot Lemnusha me detyrë koordinator i PKM-së në QNOD.

Nga QKKSH-ja në të dy takimet u prezantua shërbimi i kërkim-shpëtimit në Republikën e Shqipërisë dhe Qendra Kombëtare e Kërkim-Shpëtimit ku u ndalua te baza ligjore e shërbimit SAR në RSH, institucionet përgjegjëse, zonat e përgjegjësisë, misioni/detyra dhe struktura e QKKSH-së, stërvitja dhe trajnimi i efektivëve, si dhe detyrimet e palëve për zbatimin e Planit Kombëtar të Kërkim-Shpëtimit dhe Planit të Veprimit të tij.

Në takime u vu re një frymë bashkëpunimi dhe kohezioni për të zbatuar legjislacionin në fuqi dhe koordinuar më mirë në operacionet SAR në terren. Takimet shërbyen për të diskutuar dhe problematika në lidhje me qartësimin “kush bën çfarë” dhe njëkohësisht detyrimet e përbashkëta për të zbatuar Planin Kombëtar të Kërkim-Shpëtimit

QKKSH, strukturë kryesore e menaxhimit të operacioneve të kërkim-shpëtimit



dhe Planin e Veprimit të tij.

Me mjaft interes ishin diskutimet rreth masave të Planit të Veprimit për zbatimin e Planit Kombëtar dhe përfshirja e tyre në planëzimin vjetor të këtyre institucioneve duke marrë masa konkrete për zbatimin e tyre.

Diskutime dhe konsulta u bënë për përgatitjen e marrëveshjeve dypalëshe me këto institucione dhe përcaktimi i detyrimeve reciproke në kuadër të zhvillimit të operacioneve të

kërkim-shpëtimit në det. Në takime u diskutua edhe për përgatitjen dhe miratimin e një VKM-je për procedurën dhe masën e kompensimit të mjeteve private kur ato përdoren për qëllime të kërkim-shpëtimit. Në përfundim u bë shkëmbimi i ndërsjellë i të dhënave të përditësuara për pikat e kontaktit dhe për koordinimin e veprimeve në rast emergjencash SAR.

Gjatë takimeve u evidentuan dhe u theksua fort rritja e rolit të Qendrës

Kombëtare e Kërkim Shpëtimit, si struktura kryesore e menaxhimit të operacioneve të kërkim-shpëtimit dhe kjo më e theksuar tek strukturat e pushtetit vendor. Në këtë kuadër u kërkua rritja e mëtejshme e bashkëpunimit me këto institucione. Gjithashtu me prioritet u diskutua njohja dhe zbatimi në praktikë i Planit Kombëtar të Kërkim-Shpëtimit, si dhe Planit të Veprimit për zbatimin e tij. Në FD ka filluar një punë e mirë për zbrërthimin e tij, planëzimin e real-

izimin e detyrimeve që ka kjo forcë për shërbimin e kërkim shpëtimit në det.

Në takim u ngrit si problem nevoja e rishikimit të akteve ligjore e nënligjore për shërbimin e kërkim-shpëtimit, pasi ka disa paqartësi dhe dublime kompetencash, misionesh dhe detyrash. Aktet ligjore e nënligjore për QKKSH, Rojën Bregdetare dhe QNOD duhet të harmonizohen dhe për këtë duhet të punojnë grupe pune të përbashkëta.

Nga diskutimet në QNOD doli e nevojshme hapja e një numri të gjelbër telefonik për shërbimin e kërkim-shpëtimit, ashtu siç është për emergjencat civile, emergjencat detare, emergjencat shëndetësore, zjarrfikëset etj, me të cilat edhe ne ramë dakord dhe do të fillojmë procedurat për çeljen dhe publikimin e këtij numri.

Mjaft të domosdoshme diskutantët vlerësuan edhe zhvillimin e një stërvitje kombëtare SAR, me pjesëmarrjen e të gjitha institucioneve shtetërore ushtarake dhe civile përgjegjëse për shërbimin e kërkim-shpëtimit. Kjo stërvitje të planëzohet e drejtohet nga Koordinatori Kombëtar i Kërkim-Shpëtimit.

Nga diskutimet doli se duhet të zhvillohen aktivitete bashkëpunimi me vendet fqinje si vizita familjarizuese, trajnime e stërvitje të përbashkëta. Në përfundim të aktivitetit palët ranë dakord për një bashkëpunim të mëtejshëm në përmbushje të misionit dhe detyrave të përbashkëta.

FORCA TOKËSORE DHE KOMANDA MBËSHTETËSE

Përmbytjet: 445 trupa dhe 143 mjete të angazhuara në terren

Që prej datës 8 janar efektivë dhe mjete të Forcës Tokësore dhe Komandës Mbështetëse vazhdojnë të jenë të angazhuar në zonat e prekura nga përmbytjet e shkaktuara nga reshjet e dendura që vijnë në bien. Të gjitha strukturat e Forcave të Armatosura vazhdojnë të jenë në gatishmëri të plotë për përballimin e kësaj situatë duke vënë në dispozicion trupa dhe mjete të kalueshmërisë së lartë në shërbim të autoriteteve të pushtetit vendor dhe lokal me qëllim transportin e materialeve dhe evakuimin e personave të prekur nga përmbytjet si dhe shpërndarjen e materialeve ushqimore/veshmbathje dhe hapjen e rrugëve të bllokuara nga rrëshqitjet e dheut dhe dëborës.

Më konkretisht Forcat e Armatosura po operojnë në: Bajram Curr, Shkodër, Lezhë, Pukë, Tiranë, Durrës, Elbasan, Fier, Korcë dhe Vlorë ku në total janë angazhuar 445 trupa dhe 143 mjete. Përveç trupave të angazhuara drejtpërdrejt në operacion, trupa të tjera qëndrojnë në gatishmëri në reparte për t'iu përgjigjur



çdo situatë. Strukturat e Forcave të Armatosura vazhdojnë të mbajnë nën monitorim të vazhdueshëm situatën, në bashkëpunim të ngushtë me pushtetin vendor dhe me Agjencinë Kombëtare të Mbrojtjes Civile me

qëllim marrjen e masave të nevojshme në kohën më të shkurtër dhe eliminimin e pasojave të mundëshme. Angazhimi i Forcave të Armatosura do të vazhdojë deri në rikthimin në normalitet të situatës.

Qendra e Arsimimit Profesional të Nënoficerëve

Fillon kursi i 47-të
Bazë i Nënoficerit

Një tjetër kurs Bazë fillon në Qendrën e Arsimimit Profesional të Nënoficerëve. Në datën 25.01.2020 u hap kursi 47-të Bazë i Nënoficerit, i përbërë nga 36 kursantë ku 3 prej tyre femra.

Kursi Bazë i Nënoficerit (Faza I), zhvillohet në QAPN gjatë një harku kohor 8-javor dhe ka si qëllim zhvillimin e elementeve themelore të personalitetit të tetarit si drejtues në rol të komandantit të skuadrës dhe

Kursi 47-të Bazë i Nënoficerit, përbëhet nga 36 kursantë ku 3 prej tyre femra

detyra të njësuara me të, edukimin dhe përgjegjësinë ndaj detyrës dhe gatishmërisë luftarake, në zbatimin e urdhrave dhe forcimin e disiplinës vetjake. Gjatë këtij kursi kursantët

do të thellojnë njohuritë dhe intelektualin e tyre në modulet e mëposhtme: Liderhip, Rregullore/Ligjshmëri, Taktikë, SHLT, Përgatitje zjarri, Përgatitje fizike.



KOMANDA MBËSHTETËSE

Me mjete speciale në krye të detyrës
nga Tropoja në Brataj të Vlorës

Efektivët e Komandës Mbështetëse me forca dhe mjete special vijnë në krye të detyrës në këto ditë të reshesh të pazakonta në Tropojë, Shkodër (Bogë dhe Dajc), Durrës, Korçë, Vlorë dhe Valias, në ndihmë të komunitetit të dëmtuar.

Më konkretisht, batalioni Mështetjes Rajonale Rajonale (BMR) vijon punën në Shkodër me hapjen e segmentit rrugor Bogë-Theth nga dëborë. Gjithashtu, në Njësinë Administrative Dajc dhe Ana e Malit nga BMR është nisur me mjetet barka dhe gomone për evakuimin e banorëve të mbetur të bllokuar nga përmbytjet.

Në drejtim të Luzhës, Tropojë, BMR po punohet për thithjen e shkarkimin e rezervuarit të zonës, i cili rrezikon përmbytjen e fshatit.

Ndërkohë në Durrës mbështetja për banorët e Shijakut të cilët janë bllokuar nga përmbytjet ka filluar me evakuimin me barka të 30 personave. BMR vijon të qëndrojë në gatishmëri në këtë zonë. Nga depot e Rezervave të Shtetit në Lundër, Tiranë, Efektivët e BMR ka vijuar mbështetjen për komunitetin me



paketim dhe nëpërmjet batalionit të Transportit janë dërguar një sasi e konsiderueshme pakosh ushqimore në drejtim të Shijakut dhe Durrësit për familjet e prekura nga përmbytjet.

Gjithashtu, DMR Korçë me mjetin borëpastruese ndodhen në gatishmëri në mbështetje të kësaj prefekturë për zhbllokumin e akseve rrugore nga dëborë.

Nga ana tjetër, forcat xhenjere

ndodhen në mbështetje të komunitetit në Vlorë, në Njësinë Administrative Brataj, për thërmimin e masivit shkëmbor rënë si pasojë e rrëshqitjes së dherave, ndërsa një pjesë e efektivit ndodhet në dispozicion të IKMT-së për prishjen e kontrolluar të një objekti 5-katësh. Efektivët e Komandës Mbështetëse ndodhen në gatishpëri për tu përgjigjur cdo situatë të krijuar nga reshjet.

Xhenierët e Komandës Mbështetëse

Predha luftarake në lumin Mat,
bëhet shpërthimi i kontrolluar

Ditën e enjte të javës që kaloi, në shtratin e lumit Mat, në afërsi të Klosit u konstatua e paplasur një predhë mortaje. Ishte një banor i zonës i cili e pikasi dhe menjëherë njoftoi policinë e cila shkoi në vendin e ngjarjes. Predha ishte e mbështjellë me një leckë, ndërsa rezultoi që të ishte në të edhe djegorja e cila rrezikonte shpërthimin. Policia dhe strukturat Vendore të Mbrojtjes Civile në Klos njoftuan menjëherë Ministrinë e Mbrojtjes, e cila dërgoi një grup të repartit të xhenios. Me të mbërritur në vendin e ngjarjes forcat xheniere kanë bërë edhe një krehje tjetër të zonës ku kanë konstatuar edhe dy predha të tjera. Ata bënë shpërthim të kontrolluar duke shmangur rrezikun për banorët. Përgjegjësi i Zyrës së Mbrojtjes Civile në Bashkinë Klos, Nerim Dema ju bëri apel banorëve që zbresin në shtratin e lumit Mat, të bëjnë kujdes, pasi mund të ketë edhe predha të tjera.

Predhat dyshohet se mund të jenë mbetje nga tunelet e municioneve luftarake tek ish pazari i vjetër, tunele të cilat janë çertifikuar të pastra në vitin 2017. Por nuk përjashtohet mundësia që ato të jenë hedhur nga banorë të cilët në vitin 1997 morën municione luftarake nga këto tunele.

Xhenierët hapin rrugën Golem-Picar,
bllokuar nga rrëshqitja e dheut

Si pasojë e reshjeve të tepërta të stinës, efektivët xhenierë të Komandës Mbështetëse, prej më shumë se një javë, kanë marrë detyrën për hapjen e segmentit rrugor Golem-Picar në bashkinë e Gjirokastrës, të bllokuar totalisht nga rrëshqitjet e dheut.

Më konkretisht, xhenierët e KM-së me mjetet e tyre speciale kanë punuar intensivisht për hapjen e aksit rrugor Golem-Picar (prej 7,3 km) dhe kanë bërë të mundur përfundimin e operacionit, me rezultat hapjen e qarkullimit për këtë aks e kthimin në normalitet të lëvizjes së automjeteve e popullsisë së zonës.

Punimet u inspektuan nga ministri i Brendshëm z. Blendi Çuçi, prefekti i qarkut Gjirokastrë, kryetari i bashkisë dhe kryetari i njësisë administrative Picar, të cilët falënderuan Ministrinë e Mbrojtjes për mbështetjen dhe lavdëruan efektivët për punën e palodhur, në kohë e me cilësi. Në këto kushte të vështira atmosferike, efektivët e Komandës Mbështetëse, me forcat e mjetet në dispozicion, janë vënë në gatishmëri për të ndërhyrë në çdo rast nevojë, kur pushteti lokal nuk e përballon me kapacitetet e veta, në rast emergjencash civile.

35-Vite pjesë e Forcave të Armatosura

Ndahet nga jeta dekani i AFA,
Prof.Dr. Kolonel Agim Sula

Ditën e hënë, më 25 janar 2021, është ndarë nga jeta nga sëmundja e rëndë e shkaktuar nga COVID-19, me gjithë kujdesin shëndetësor, dekani i Akademisë së Forcave të Armatosura, Prof. Dr. Kolonel Agim Sula.

Agimi u lind më 3 korrik 1962 në Selitë të Tiranës, në një familje me ndjenja të larta patriotike e lirishtese. Me dëshirën e madhe për të qenë ushtarak, Agimi kreu Shkollën e Mesme Ushtarake “Skënderbej” dhe Shkollën e Bashkuar të Oficerëve me rezultate të shkëlqyera. Në vitin 1985 u titullua oficer aktiv, duke nisur në këtë mënyrë karrierën ushtarake, sa të bukur, aq edhe të vështirë.

Gjatë karrierës së tij mbi 35-vjeçare si oficer aktiv, Agimi kreu me përkushtim e devotshmëri një sërë detyrash të rëndësishme duke filluar nga detyra e komandantit të togës, sekretar i Komitetit të Rinisë dhe komisar batalioni në Shkollën Ushtarake “Skënderbej” e deri komandant i Akademisë së Forcave të Armatosura, këshilltar ligjor i shefit të Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, pedagog i Shkencave Sociale, shef departamenti, shef fakulteti e dekan në Akademinë e Forcave të Armatosura.

Agimi ishte një nga ata ushtarakë që e kishte pasion profesionin e tij, ishte dhe mbeti deri në fund të jetës modeli i një njeriu të dashur, fjalëpak e punëshumë, zemërmirë, i një ushtaraku krijues e studiues. Përveç dhuntisë e talentit të tij, këtë ia mundësonin edhe kualifikimet e shumta në fushën e sociologjisë e drejtësisë, si dhe të studimeve shkencore në fushën akademike të kryera gjatë gjithë karrierës ushtarake, duke mbajtur titullin e lartë “Profesor Doktor”. Për të koha e lirë ishte libri, revista, studimi, pena, e kompjuteri.

Agimi ishte një ndër pedagogët e rrallë të Akademisë së Mbrotjtjes, që mësimdhënien e kishte transformuar në art. Ai ka dhënë mësim në të gjitha kurset pasuniversitare që zhvillohen në Akademinë e Mbrotjtjes. Vlerësimi më i lartë për të nuk ishin dekoratat, as edhe titujt shkencor që kishte fituar me punë dhe djersë, por vlerësimi i sinqertë që i bënin studentët, si një pedagog bashkëkohor e profesionist i kompletuar, që i kishte lezet fjala para auditorit.

Kontributi i tij në Forcat e Armatosura është i gjithanshëm në tërë procesin e transformimit të arsimit ushtarak e përshtatjen e tij me arsimin e lartë në Shqipëri, në drejtim të hartimit e zbatimit të ligjeve në fushën ushtarake. por ajo që mbahet mend nga pjesa më e madhe e oficerëve, është periudha që ka qenë pedagog në Akademinë e Forcave të Armatosura. ku shfaqti cilësitë më të mira të një mësimdhënësi të niveleve të larta, por edhe të një prindi dhe edukatori për studentët ushtarakë. Për shërbimet e shquara në kryerjen e detyrave të ngarkuara me përkushtim e devotshmëri, Agimi ishte vlerësuar me urdhra e medalje të ndryshme. Në emër të të gjithë personelit të Forcave të Armatosura, Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH-it, gjeneralmajor Bajram Begaj me anë të një telegrami i ka shprehur ngushëllimet më të thella dhe të sinqerta familjes së kolonel Agim Sulës për humbjen e parakohshme të njeriut të tyre më të shtrenjtë.



MINISTRJA OLTA XHAÇKA:

Kolonel Agim Sula, një
prej pedagogëve më
të vlerësuar të AFA-së

Eshtë ndarë nga jeta profesor Agim Sula, një prej pedagogëve më të vjetër dhe më të vlerësuar të Akademisë së Forcave të Armatosura.

“Trishtim e dhimbje pas lajmit për largimin nga jeta të Profesor Doktor, Kolonel Agim Sula, një prej pedagogëve më të vjetër dhe më të vlerësuar të Akademisë së Forcave të Armatosura. Pata



nderin të punoj me të, për një prej projekteve që ai kishte aq shumë përzemër: akreditimin e AFA-së si i vetmi institucion i arsimit të lartë për mbrojtjen dhe sigurinë në vend”, shkruan në mesazhin ngushëllues, Oltë Xhaçka, ish Ministre e Mbrotjtjes, aktualisht Ministre për Europën dhe Punët e Jashtme.

Xhaçka shprehu, “mirënjohje e nderim për pedagogun, që me shumë përkushtim kontribuoi në përgatitjen e brezave të tërë ushtarakësh dhe punoi m shumë profesionalizëm, për atë që Akademia e Forcave të Armatosura është sot. Ngushëllimet më të sinqerta familjes, miqve e kolegëve”, shkruan ministrja Xhaçka.

MINISTRI I MBROJTJES NIKO PELESHI

Kolonel Agim Sula,
pedagogu i shkëlqyer i AFA-së

“**P**rofesor Doktor, Kolonel Agim Sula, pedagogu i shkëlqyer i Akademisë së Forcave të Armatosura ka humbur betejën me COVID-19. Ngushëllimet më të sinqerta për familjen dhe kolegët”, -shpreh ngushëllimin e tij ministri Peleshi në facebook.

Profesor Doktor, Kolonel Agim Sula ishte një prej pedagogëve më të vjetër dhe të vlerësuar në Komandën e Doktrinës dhe Stërvitjes. Karriera e tij në fushën e arsimit nis prej vitit 1998 nga pedagog i të drejtës ushtarake. Profesor Doktor, Kolonel Agim Sula prej 23 vitesh edukoi të rinjtë e të rejtat në Akademinë e Forcave të Armatosura. Ai ka qenë edhe komandant i Akademisë së Mbrotjtjes, rektor i AM-së si dhe dekan fakulteti.



ZV.MINISTRI I MBROJTJES, PETRO KOÇI:

Kolonel Agim Sula, një emblemë
e Akademisë Ushtarake

“**L**ajm i trishtë”, - shkruan zv.ministri i Mbrotjtjes, Petro Koçi me anë të një postimi në rrjetet sociale. “Dhimbje dhe humbje e madhe, largimi nga jeta i Profesor Doktor, Kolonel Agim Sula. Një emblemë e Akademisë Ushtarake, e intelektualizmit dhe profesorit ushtarak, një njeri me cilësi të adhureshme, një familjar i përkushtuar nuk do jetë më midis nesh. Covidi na e bëri borxh serish me ikjen tënde Agim! Për ty nuk donim parajsën, por jetën. Lamtumirë Kolonel!”, shkruan Petro Koçi. Kolonel Agim Sula për mbi dy dekada ju kushtua edukimit ushtarak. “Edukimi elit ushtarak është sot një nga sfidat e ushtrisë shqiptare, krahas përsosjes së vazhdueshme dhe integriteteve gjithnjë e më të mëdha. Shqipëria është sot një vend anëtar i NATO-s, dhe si e tillë gjithnjë del e nevojshme që niveli i ushtrisë së saj të jetë në shkallën më të lartë. Në këtë kuadër, arsimit i lartë elit ushtarak, i është nënshtruar një procesi reformimi të madh”, deklaronte Kolonel Prof. Dr. Kolonel Agim Sula, në nëntor 2020.



Shkëlqeu në përvetësimin e dijes ushtarake

PROF. ASOC. DR. ZAHO GOLEMI
PROF. ASOC. DR. BERNARD ZOTAJ**"Sukses është puna,
asaj i besoni..."**

Meteor i dijes ushtarake që nuk shuhet

Kushtuar Kolonel Prof. Asoc. Dr. Agim Qamil Sula (3.7.1962-24.1.2021), ish-Dekan i FMS-së në AFA, që u shua nga Covid-19, do përkujtohet përherë si një meteor që ndriçon, sepse misionarët e dijes nuk shuhet asnjëherë

Agim Sula ka qenë dhe do mbetet shoku ynë përjetësisht dhe pse "zemereku" i jetës u ndal padrejtësisht për Të në moshën 58 vjeçare. Askush prej shokëve, miqve e kolegve nuk e prisnin një largim kaq të hidhur dhe të dhimbshëm nga virusi vrasar. Forcat e Armatosura e kishin për nder që e kishin pjesë të armatës, fjalëpeshë, të dashur dhe të çmuar në shoqëri, kolonelin korrekt, ushtarakun model dhe të apasionuar pas mësimdhënies, pedagogun dhe punonjësin shkencor të përkushtuar ndaj shkencës ushtarake. Akademia e Forcave të Armatosura humbi një shef dhe pedagog me nivel, me kompetencë në dije, i cili arriti ta fuste auditorin në rrjedhën normale, si dhe të zotëronte edhe situatën më të vështirë. Me sjelljen e tij "të butë", që frymëzonte dhe e bënte të dashur lëndën, thjeshtëzonte kompleksitetin dhe "vuajtjet", për të rritur nivelin e dijeve të qëndrueshme tek studentët ushtarak të Akademisë së Forcave të Armatosura.

"Shef Gimi" siç i thërrisnin, punoi jo vetëm në shkollat ushtarake, por dhe në hapësirën administrative ushtarake shqiptare, duke shoqëruar kurse të ndryshme të AFA-së nga Jugu në Veri në praktika dhe stërvitje të ndryshme stërvitore. Ai ishte i njohur për "shakatë" dhe rromuzet, por dhe dinte ti priste ato, duke lëvizur punën dhe mendimin më përpara në forma dhe metoda akademike e pedagogjike. Ai ishte përpunues i mendimit, shkruante, debatonte, kërkues ndaj vetes dhe të tjerëve, intelektual, njerëzor, e njeri tepër shoqëror. Ai krijoi një familje model dhe përballoi me dinjitet sfidat e kohës, e së bashku me bashkëshorten Lira, lindën, rritën edukuan dhe i apasionuan pas studimeve, djemtë Deni dhe Dioni.

Agim Sula shkallët e karrierës i ngjiti gradualisht nga komandant toge në Shkollën "Skënderbej" në vitin 1985, deri në dekan dhe punoi me përkushtim për 36 vite me radhë. Agim Sula njihet nga të gjithë brezat e ushtarakëve si mësimdhënës i pandërprerë, instruktor dhe pedagog në institucionet e sistemit të arsimimit ushtarak të Forcave të Armatosura duke dhënë e shpjeguar lëndët "Forcat e Armatosura dhe shteti ligjor", "E drejta ndërkombëtare humanitare", etj. Te kolegët dhe studentët ka ngelur mesazhi se "burimi i pashtershëm i suksesit është puna, asaj i besoni". Këtë mësim Agimi e kishte nga përvoja si nxënës, student, oficer në gjithë nivelet e karrierës ushtarake dhe se "fjalën ja jepte të parës punës".

**Shkëlqeu në përvetësimin
e dijes ushtarake**

Agim Sula u lind në Selitën e Malit në Tiranë, më 3 korrik 1962. Shkollën fillore dhe tetëvjeçare i ndoqi në fshatin e lindjes. Më tej, nga dashuria për

profesionin e oficerit ndoqi studimet në Shkollën e Mesme Ushtarake "Skënderbej" në vitet 1977-1981. Shkëlqeu në të gjitha vitet, u aktivizua me organizatën e rinisë, duke qenë dhe sekretar i saj, si dhe anëtar i rrethit shkencor në shkollë. Përfundimi me rezultate të larta i shkollës së mesme, i bëri krenarë prindërit dhe gjithë rrethin familjar. Në vitet 1981-1982 krye periudhën e stazhit pas shkollës së mesme në Ksamil të Sarandës.

Duke qenë një nxënës premtues nis studimet më 1 shtator 1982 në Shkollën e Lartë të Bashkuar të Oficerëve dhe për tre vite u dallua në të gjitha disiplinat ushtarake dhe në fund të shkollës doli ndër studentët më të shkëlqyer të shkollës. Ai mbrojti temën e diplomës "Kompania e këmbësorisë në mësimje", privilegj për studentët e dalluar. U titullua oficer më 25 korrik 1985 dhe vendi i tij ishte "i rezervuar" në Tiranë, sepse studentët e shkëlqyer e kishin vendin në shkollat ushtarake. Nisi rrugëtimin ushtarak, komandant toge në shkollën "Skënderbej". Studimet e nivelit universitar i mbylli në Universitetin e Tiranës, në Fakultetin e Drejtësisë, Dega Jurisike më 3 korrik 1996. Agim Sula vijoi studimet në Akademinë e Mbrojtjes në vitet 2001-2002, ndërsa në vitet 2012-2013 kryen Kursin e Lartë të Sigurisë dhe Mbrojtjes në Akademinë e Forcave të Armatosura, si dhe mjaft kurse e kualifikime të tjera brenda dhe jashtë vendit.

Në vitet 2003-2006 në institucionin e Akademisë së Mbrojtjes "Spiro Moisiu", punoi për temën doktorature "Përmbushja e misionit të FA në përputhje me Ligjin e Konfliktit të Armatosur dhe rregullat e angazhimit në përdorimin e forcës", duke fituar gradën shkencore "Doktor i shken-

cave ushtarake" me nr. 4427, datë 10.07.2006. Ndërsa në vitin 2013, komisioni i posaçëm i vlerësimit të titujve akademike për punën dhe kontributin e tij i akordon titullin akademik "Profesor i Asociuar" me vendimi nr. 37 dhe me nr. regj. 389, në Ministrinë e Arsimit.

Kontributi në jetën akademike

Të shumta janë materialet akademike që ka lënë Kolonel Prof. Agim Sula. Kështu mund të përmendim "Ligji i Konfliktit të Armatosur" (2009), "Libri i arsimimit në fushën e udhëheqjes ushtarake dhe shkencave shoqërore", me bashkëautorësi (2015), "Doktrina Ushtarake e FARSH DP-1" (2013), "55 vjet Akademi e Forcave të Armatosura 10 maj 1958-10 maj 2013" (2013), etj. Ai ka qenë në bordin e konferencës: "International Scientific Conference "100 years Albanian State-100 years Albanian Armed Forces/ The declaration of Independence of Albania and the internacional environment", December 2012.

“Ne të dy ndajmë mendimin se bashkëpunimi ushtarak është një mjet efektiv për ndërtimin e marrëdhënieve konstruktive dhe miqësore midis dy vendeve, të tilla si Republika e Maqedonisë Veriore dhe Republika e Bullgarisë. Është një nder për mua të mirëpres gjeneral-lejtnant Gyurçinovski në bordin e Forcave Ajrore Bullgare, ku gjatë udhëtimit do të kemi mundësinë për të diskutuar tema dhe çështje me interes të përbashkët, të cilat i kemi shumë”, tha Shefi i Mbrojtjes bullgare Admirali Emil Eftimov.



Admiral Emil Eftimov dhe Gjeneral Lejtnant Vasko Gyurchinovski

Një udhëtim së bashku drejt takimit të Komitetit Ushtarak në Bruksel

Shefi i Mbrojtjes i Bullgarisë, Admiral Emil Eftimov dhe Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë së Republikës së Maqedonisë Veriore, Gjeneral Lejtnant Vasko Gyurchinovski, më, 26 janar, u nisën nga aeroporti bullgar “Vrazhdebna” drejt Brukselit me një avion transportues ushtarak, “S-27J Spartanov” te Forcave Ajrore Bullgare. Në Bruksel, Belgjikë, ata ishin pjesë në një takim në nivelin e Shefave të Mbrojtjes të Komitetit Ushtarak të NATO-s.

“Ne të dy ndajmë mendimin se bashkëpunimi ushtarak është një mjet efektiv për ndërtimin e marrëdhënieve konstruktive dhe miqësore midis dy vendeve, të tilla si Republika e Maqedonisë Veriore dhe Republika e Bullgarisë. Është një nder për mua të mirëpres gjeneral-lejtnant Gyurçinovski në bordin e Forcave Ajrore Bullgare, ku gjatë udhëtimit do të kemi mundësinë për të diskutuar tema dhe çështje me interes të përbashkët, të cilat i kemi shumë”, tha Shefi i Mbrojtjes bullgare Admirali Emil Eftimov.

“Shpreh kënaqësi dhe nder i madh për ftesën e Admiralit Eftimov për të qenë në Sofje, në Republikën e Bullgarisë-një vend vëllazëror, miqësor dhe aleat. “Faleminderit për ftesën për të udhëtuar së bashku në takimin e Komitetit Ushtarak në Bruksel, ku do të kemi kohë, si gjatë aktivitetit atje ashtu dhe gjatë fluturimit, për të



shkëmbyer informacione me interes të përbashkët për Forcat tona të Armatosura”, tha Shefi i Shtabit të Ushtrisë te Maqedonisë Veriore.

Komiteti Ushtarak i NATO-s diskutonë operacionet, misionet dhe veprimtaritë operationale të Aleancës, si dhe Konceptin Euro-Atlantik të

Asgjësimit dhe Mbrojtjes.

Në përgjigje të një pyetje gazetareske, Admirali Eftimov shpjegoi se axhenda e takimit përfshinte

gjithashtu një sesion të veçantë me mësimet e nxjerra nga praktika mbi rolin e unionit në kundërveprimin me pandeminë COVID-19. Ai kujtoi se që nga fillimi i pandemisë, NATO ka qenë e përfshirë në mënyrë aktive në organizimin dhe masat për të trajtuar koronavirusin në një aspekt logjistik dhe përmes një numri mekanizmesh koordinimi. Lidhur me vaksinimin në Forcat e Armatosura Bullgare, Shefi i Mbrojtjes theksoi se ai do të kryhet në kohë në përpunje me Planin Kombëtar të Vaksinimit. Admirali Eftimov ishte i prerë se ndërrimi i misioneve jashtë vendit është një përparësi.

“Një rotacion i planifikuar i kontigjentit tonë në Afganistan po afrohet dhe ai duhet të certifikohet. Theksoj se vaksinimi është një veprim vullnetar. Ne jemi të detyruar të sigurojmë një numër të mjaftueshëm të vaksinave, për të cilat kemi një komunikim të shkëlqyeshëm me organet e Akademisë Mjekësore Ushtarake dhe spitaleve multidisiplinare për trajtim në vend, ne kemi përgatitur listat e atyre që dëshirojnë të vaksinohen”, përfundoi Shefi i Mbrojtjes.

Në gardë ka 60 pozicione ushtarake të lira

Garda Kombëtare bullgare (NGC) ka njoftuar një konkurs për të plotësuar pozicionet e lira ushtarake për ata që dëshirojnë të bëhen pjesë e formacionit-një simbol i shtetësisë Bullgare. Me urdhër të Ministrit të Mbrojtjes të 13 Janarit 2021, u shpall një konkurs për një total prej 60 pozicione ushtarake të lira, nga të cilat 50 pozicione për “roje” dhe 10 pozicione të tjera për “inxhinier të zërit”, “shofer i vogël” dhe të tjerë.

Arsimi i kërkuar minimal i përfunduar është i mesëm. Aplikantët gjithashtu duhet të jenë të aftë për shërbimin ushtarak dhe të arsyeshëm, jo të dënuar, të mos kenë ndonjë shtetësi tjetër. Aplikantët mund të jenë deri në 40 vjet.

Kandidatët për shërbimin ushtarak në NGC duhet të paraqesin një kërkesë tek komandanti i saj dhe dokumentet e



nevojshme deri më 8 mars 2021 përmes strukturave të Rrethit Ushtarak Qendror në adresën e tyre të përhershme të banimit.

Konkursi do të mbahet në 29 dhe 30 mars 2021 në NGC, Sofje, Blvd 2 Asen Yordanov. Ai përfshin matjen e të dhënave antropometrike të kan-

didatëve për roje (të cilët kanë një kërkesë shtesë për të qenë me gjatësi 175-185 cm), provimi i trajnimit fizik, testi i kulturës së përgjithshme dhe intervista. Provimi në trajnimin fizik të kandidatëve do të kryhet duke përcaktuar cilësitë për forcë, shpejtësi.

NJË EKIP I SPECIALIZUAR I FORCAVE TOKËSORE

Shkatërrohet një municion të pashpërthyer në Stara Zagora

Ekipi i specializuar i zbulimit të Brigadës së 2-të të mekanizuar ka vepruar me mjete teknike duke realizuar shkatërrimin e një municioni të pashpërthyer me një gjatësi prej rreth 400 mm dhe diametër rreth 120 mm, të gjetur më 24 janar në lumin Bedechka në perëndim të Samara në Stara Zagora.

Më, 25 janar, me ndihmën e zhytësve nga ekipi i specializuar, municionet u hoqën nga një thellësi prej 1.2 m dhe u transportuan në terrenin stërvitor “Lilac”-Stara Zagora, ku u shkatërrua më vonë.

Ekipi i specializuar i përbërë nga 6 ushtarake dhe 2 pjesë të pajisjeve operoi nën udhëheqjen e kapitenit të vjetër Yordan Yordanov. Formacioni u aktivizua në bazë të një kërkesë të bërë nga Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Brendshme dhe me urdhër të Komandantit të Forcave Tokësore, Gjeneral Major Mihail Popov.



27 janar, Dita Ndërkombëtare e Përkujtimit të Holokaustit

Holokausti: Një histori hyrëse

Holokausti (i quajtur edhe He-Shoah në hebraisht) i referohet periudhës nga 30 janari 1933 - kur Adolf Hitler u bë kancelar i Gjermanisë - deri më 8 maj 1945, kur lufta në Evropë përfundoi zyrtarisht. Gjatë kësaj kohe, hebrenjtë në Evropë iu nënshtruan një persekutimi progresivisht më të ashpër që përfundimisht çoi në vrasjen e 6.000.000 hebrenjve (1.5 milion prej tyre ishin fëmijë) dhe shkatërrimin e 5,000 komuniteteve hebreje. Hebrenjtë që vdiqën nuk ishin viktimat e luftimeve, që shkatërruan Evropën gjatë Luftës së Dytë Botërore. Përkundrazi, ata ishin viktimat e përpjekjes së qëllimshme dhe sistematike të gjenocidit hitlerian për të asgjësuar të gjithë popullsinë hebraike të Evropës, një plan që Hitleri e quajti “Zgjidhja Përfundimtare” (Endlösung). Pas disfatës së saj në Luftën e Parë Botërore, Gjermanisë sipas Traktatit të Versajës, i u zvogëlua territori i saj i para luftës, ju ulën në mënyrë drastike forcat e saj të armatosura, ju kërkua njohja e fajit të saj për luftën dhe ju përcaktua që ajo të paguante dëmshpërblimet për fuqitë aleate. Me perandorinë gjermane të shkatërruar, u formua një qeveri e re parlamentare e quajtur Republika e Weimarit. Republika vuante nga paqëndrueshmëria ekonomike, e cila u përkeqësua gjatë depresionit në të gjithë botën pas përplasjes së tregut të aksioneve në New York në 1929.

Më 30 janar 1933, Adolf Hitler, udhëheqësi i Partisë Nacional Socialiste të Punëtorëve Gjerman (Nazist), u emërua kancelar i Gjermanisë nga Presidenti Paul von Hindenburg pasi partia naziste fitoi një përqindje të konsiderueshme të votave në zgjedhjet e vitit 1932. Partia kishte përfitur nga trazirat politike në Gjermani për të fituar një terren elektoral. Nazistët nxitën përplasje me komunistët dhe zhvilluan një fushatë të egër propagandistike kundër kundërshtarëve të saj politikë-qeveria e dobët e Weimar dhe hebrenjtë të cilët nazistët i fajësuan për sëmundjet e Gjermanisë.

Një nga propagandat më të mëdha ishte nën logon: “Hebrenjtë janë fatkeqësia jonë”.

Një mjet kryesor i sulmit propagandistik të nazistëve ishte gazeta javore naziste “Der Stürmer” (Sulmuesi). Në fund të faqes së parë të çdo numri, me letra të theksuara, gazeta deklaronte: “Hebrenjtë janë fatkeqësia jonë!” “Der Stürmer” gjithashtu rregullisht shfaqte karikatura të hebrenjve në të cilët ata ishin karikatur si majmunë. Ndikimi i gazetës ishte i gjerë, deri në vitin 1938 rreth gjysmë milioni kopje u shpërndanë çdo javë.

Menjëherë pasi u bë kancelar, Hitleri bëri thirrje për zgjedhje të reja në një përpjekje për të marrë kontrollin e plotë të Reichstag, parlamentit gjerman, për nazistët. Nazistët përdorën aparatin qeveritar për të terrorizuar partitë e tjera. Ata arrestuan udhëheqësit e tyre dhe ndaluan takimet e tyre politike. Nuk vonoi dhe qeveria, me pretendimin e kontrollit të komunistëve, shfuqizoi të drejtat dhe mbrojtjet individuale: liria e shtypit, dhe e shprehjes u anulua, si dhe e drejta për privatësi. Kur zgjedhjet u mbajtën në 5 Mars, nazistët morën gati 44 përqind të votave, dhe me 8 përqind të ofruara nga Konservatorët,



fituan shumicën në qeveri. Nazistët lëvizën me shpejtësi për të konsoliduar pushtetin e tyre në një diktaturë. Më 23 mars, u miratua Akti i Mundësimit. Ai sanksionoi përpjekjet diktatoriale të Hitlerit dhe ligjërisht i dha mundësi t'i ndiqte ato më tej. Nazistët marshuan me makinerinë e tyre të frikshme të propagandës për të bërë të heshtnin kritikët e tyre. Ata gjithashtu zhvilluan një forcë të sofistikuar policore dhe ushtarake.

Në fund të vitit 1934 Hitleri kishte kontrollin absolut të Gjermanisë, dhe fushata e tij kundër hebrenjve ishte në zhvillim e sipër. Nazistët pretenduan se hebrenjtë kishin korruptuar kulturën e pastër gjermane me ndikimin e tyre “të huaj”. Ata i portretizuan hebrenjtë si të ligë dhe frikakakë, dhe gjermanët si punëtorë, të guximshëm dhe të ndershëm. Hebrenjtë, pretenduan nazistët, të cilët përfaqësoheshin shumë në financë, tregti, shtyp, letërsi, teatër dhe arte, kishin dobësuar ekonominë dhe kulturën e Gjermanisë. Raca superiore ishte “Arianët”, gjermanët. Fjala ariane, “rrjedh nga studimi i gjuhësisë, i cili filloi në shekullin XVIII dhe në një moment përcaktoi që gjuhët indo-gjermane (të njohura edhe si ariane) ishin superiore në strukturat, larinë dhe fjalorin e tyre ndaj gjuhëve semite që kishte evoluar në Lindjen e Afërt. Ky gjykim çoi në një hamendje të caktuar për karakterin e popujve, që flisnin këto gjuhë; përfundimi ishte se popujt ‘Arianë’ ishin superiorë nga ata ‘Semitikë’.

Hebrenjtë izolohehen nga shoqëria

Nazistët kombinuan teoritë e tyre rreth me teoritë evolucionare të Charles Darwin për të justifikuar trajtimin e tyre ndaj hebrenjve. Gjermanët, si më të fortë dhe më të aftë, ishin të destinuar të sundonin, ndërsa hebrenjtë e dobët ishin të dënuar për zhdukje. Hitleri filloi të kufizonte hebrenjtë me legjislacion dhe terror, gjë që përfshinte djegien e librave të shkruar nga hebrenjtë, largimin e hebrenjve nga profesionet e

tyre dhe shkollat publike, konfiskimin e bizneseve dhe pronave të tyre, përjashtimin e tyre nga ngjarjet publike. Legjislacioni më famëkeq i antihebrenjve ishin Ligjet e Nurembergut, të miratuara më 15 shtator 1935. Ata formuan bazën ligjore për përjashtimin e hebrenjve nga shoqëria gjermane dhe politikën hebraike progresive të kufizuara të gjermanëve. Shumë hebrenj u përpoqën të largoheshin nga Gjermania dhe mijëra patën sukses duke imigruar në vende të tilla si Belgjika, Çekosllovakia, Anglia, Franca dhe Holanda. Ishte shumë më e vështirë të dilje nga Evropa. Hebrenjtë hasën kuota të ashpër të emigracionit në shumicën e vendeve të botës. Edhe nëse do të merrnin dokumentet e nevojshme, ata shpesh duhej të prisnin me muaj, ose vite para se të largoheshin. Shumë familje nga dëshpërimi dërguan së pari fëmijët e tyre.

Më 9-10 nëntor 1938, sulmet ndaj hebrenjve u bënë të dhunshme. Hershel Grynszpan, një djalë hebre 17-vjeçar i dëshpëruar nga deportimi i familjes së tij, qëlloi Ernst vom Rath, sekretarin e tretë në ambasadën gjermane në Paris, i cili vdiq më 9 nëntor. Huliganët nazistë e përdorën këtë atentat si pretekst për të nxitur një natë shkatërrimi që tani njihet si “Kristallnacht” (nata e xhamit të thyer). Ata plaçkitën, shkatërruan shtëpitë dhe bizneset hebreje dhe dogjën sinagogat. Shumë hebrenj u rrahën dhe u vranë; 30,000 hebrenj u arrestuan dhe u dërguan në kampe përqendrimi.

“Zgjidhja Finale”

Në qershor 1941 Gjermania sulmoi Bashkimin Sovjetik dhe filloi “Zgjidhjen Përfundimtare”. U formuan katër grupe lëvizëse vrasjesh të quajtur “Einsatzgruppen” A, B, C dhe D. Secili grup përmbante disa njësi komando. “Einsatzgruppen” mbledhi hebrenjtë qytet më qytet, i zhveshi, i rreshtoi dhe i gjuajti me armë automatike. Të vdekurit do të binin në gropa për t'u varrosur në varre masive. Në masakrën famëkeqe të Babi Yar, afër Kievit, 30,000-35,000 hebrenj u vranë brenda dy ditësh. Përveç operacioneve

të tyre në Bashkimin Sovjetik, “Einsatzgruppen” kreu vrasje masive në Poloninë lindore, Estoninë, Lituaninë dhe Letoninë. Vlerësohet se deri në fund të vitit 1942, “Einsatzgruppen” kishte vrarë më shumë se 1.3 milion hebrenj. Më 20 janar 1942, disa zyrtarë të lartë të qeverisë gjermane u takuan për të koordinuar zyrtarisht degët administrative ushtarake dhe civile të sistemit nazist për të organizuar një sistem të vrasjeve masive të hebrenjve. Ky takim, i quajtur “Konferenca e Wanneseit”, shënoi fillimin e operacionit të shfarosjes gjithëpërfshirëse [të hebrenjve] në shkallë të plotë dhe vuri bazat për organizimin e tij, i cili filloi menjëherë pas përfundimit të konferencës. Ndërsa nazistët vranë grupe të tjera kombëtare dhe etnike, të tilla si: një numër i të burgosurve sovjetikë të luftës, intelektualë polakë dhe ciganë, vetëm hebrenjtë u shënuan për asgjësim sistematik dhe total. Hebrenjtë u veçuan për “Trajtim të Veçantë” (Sonderbehandlung), që do të thoshte që burrat, gratë dhe fëmijët hebrej do të vriteshin në mënyrë metodike me gaz helmues. Në pothuajse çdo vend të pushtuar nga nazistët, hebrenjtë u detyruan të mbanin shenjat që i shënonin si hebrenj, dhe më pas gradualisht u transportuan në qendrat e vrasjes. Kampet e vdekjes ishin në thelb fabrika për vrasjen e hebrenjve. Gjermanët dërguan mijëra hebrenj tek ata çdo ditë. Brenda disa orësh nga mbërritja e tyre, hebrenjtë u ishin hequr pasuritë dhe trupat e tyre u dogjën në krematoriume të projektuara posaçërisht. Përafërsisht 3.5 milion hebrenj u vranë në këto kampe vdekjeje. Shumë hebrenj të shëndetshëm dhe të fortë nuk u vranë menjëherë. Përpjekja e luftës së gjermanëve dhe “Zgjidhja Përfundimtare” kërkonte një forcë të madhe njerëzore, kështu që gjermanët rezervuan pishina të mëdha hebrenjsh për punë skllëvërisht. Këta njerëz, të burgosur në kampe të përqendrimit dhe të punës, u detyruan të punojnë në municione gjermane dhe fabrika të tjera, të tilla si I.G. Farben dhe Krupps, dhe kudo që nazistët kishin nevojë për punëtorë. Ata punuan nga agimi deri

në errësirë pa ushqim dhe strehim të përshtatshëm. Në muajt e fundit të Rajhut të Hitlerit, ndërsa ushtritë gjermane tërhiqeshin, nazistët filluan të marshonin të burgosurit ende gjallë në kampe të përqendrimit në territorin që ata ende kontrollonin. Gjermanët i detyruan hebrenjtë të uritur dhe të sëmurë të ecnin qindra milje. Shumica vdiqën, ose u qëlluan gjatë rrugës. Rreth një e katërta e një milion hebrenjve vdiqën në marshimet e vdekjes.

Rezistenca Hebreje

Shtypja dërmuese e gjermanëve dhe prania e shumë bashkëpunëtorëve në popullata të ndryshme lokale kufizuan rëndë aftësinë e hebrenjve për të rezistuar. Rezistenca hebraike ndodhi, në disa forma. Qëndrimi i gjallë, i pastër dhe vëzhgimi i traditave fetare hebraike përbënte rezistencë nën kushtet çnjerëzore të imponuara nga nazistët. Forma të tjera të rezistencës përfshinin përpjekjet e arratisjes nga kampet. Shumë që patën sukses të shpëtonin, jetonin në pyje dhe male në kampe familjare dhe në luftime kundër njësisë partizane. Megjithatë, sapo ishin të lirë, hebrenjtë duhej të luftonin me banorët lokalë dhe grupet partizane, që shpesh ishin haptas armiqësorë. Hebrenjtë gjithashtu organizuan revolta të armatosura në Vilna, Bialystok, Bedzin-Sosnowiec, Krakow dhe Varshavë. Hebrenjtë u rebeluan në kampe të vdekjes së Sobibor, Treblinka dhe Auschwitz. Të gjitha këto veprime të rezistencës ishin kryesisht të pasuksesshme përballë forcave superiore gjermane, por ato ishin shumë të rëndësishme shpirtërisht, duke u dhënë hebrenjve shpresë se një ditë nazistët do të munden.

Çlirimi

Kampet u çliruan gradualisht, ndërsa Aleatët përparuan duke zbrapsur ushtrinë gjermane. Për shembull, Maidanek (afër Lublin, Poloni) u çlirua nga forcat Sovjetike në Korrik 1944, Auschwitz në Janar 1945 nga Sovjetikët, Bergen-Belsen (afër Hanover, Gjermani) nga Britanikët në Prill 1945, dhe Dachau nga Amerika në Prill 1945. Në fund të luftës, midis 50,000 dhe 100,000 hebrenj të mbijetuar po jetonin në tre zona të okupimit: Amerikan, Britanik dhe Sovjetik. Brenda një viti, kjo shifër u rrit në rreth 200,000. Zona amerikane e okupimit përmbante më shumë se 90 përqind të hebrenjve të zhvendosur. Numri i përgjithshëm prej gjashtë milion hebrenj të vrarë gjatë Holokaustit, i cili doli nga gjyqet e Nurembergut, është gjithashtu një vlerësim. Numrat kanë qenë ndërmjet pesë dhe shtatë milion të vrarë. Numri i saktë nuk do të dihet kurrë për shkak të shumë njerëzve vrasjet e të cilëve nuk janë regjistruar dhe trupat e të cilëve ende nuk janë gjetur.

17 janar 1468: 553 vite nga vdekja e Skenderbeut

Portreti origjinal i Skënderbeut në Kodikun e katërt në Bibliotekën kastroiotase

NGA FOTAQ ANDREA

“Në kemi pasqyrë Skënderbenë, i përqasur me Shën Luisin e Francës”. Me këtë thënie diamant të Faik Konicës te “Albania” e nisim shkrimin tonë për Heroin Kombëtar Gjergj Kastrioti, në kërkim të pasqyrës së tij të vërtetë identitare dhe origjinale në bazë të dëshmvive dhe veprave të artit që na kanë ardhur gjer më sot.

Nuk ka si të mos vëmë në dukje që në fillim, se katër vjet pas Kuvendit dhe Lidhjes së Lezhës, emri i Skënderbeut ishte bërë tanimë i njohur në Europë për fitoret e korrura të shqiptarëve ndaj osmanëve, që prej betejës së Torviollit (v. 1444) deri në qëndresën e Sfetigradit më 1448. Fakti historik është i tillë që sipas dëshmisë në “Notice historique sur la Maison de Saint-Mauris” një kështjellë në Savojë quhej “Fort de Scanderberg” (Fortesa e Skënderbeut) ose “Tour de Scanderberg” (Kulla e Skënderbeut). Olivier de la Marche, historian, diplomat, kapiten e kronikan i kohës, e përmend këtë fortifikatë më 1448, në kulmin e luftërave civile në Francë, kur Filip i Mirë (Philippe le Bon), që do t’i dërgonte Skënderbeut ambasadorë pas rrethimit të parë e të dytë të Krujës, ndërmerre luftërat e tij në Franshë Kontenë e Burgonjës.

Pikërisht, kësaj periudhe, viteve 1448-1451 u referohet At Vincens Malaj kur i njeh Antonio Pisano-s (Pisanello, 1395-1455), mbi bazën e një hipoteze të parashtruar nga Leonardo de Martino da Greci-autorësinë e gravurimit të medaljonit me portretin ndoshta më të hershëm të Skënderbeut, që ruhet në Zagreb, pothuaj i ngjashëm me atë që ruhet në muzeun numizmatik të Berlinit.

Para se të shohim rrethanat se si mund të ketë ndodhur realizimi i këtij/këtyre portreteve, le të themi në parantezë se përgjithësisht, në periudhën e Rilindjes italiane, çdo lloj veprë arti, e sidomos gravurimet dhe derdhjet e medaljoneve apo miniaturat e ndriçuara (enluminuret) në kodikë bëheshin tek artistët me porosi të veçantë: për të nderuar figurën historike që ato pasqyronin apo bëmat e këtij të fundit. Këto vepra artistike shërbenin kësaj si dhurata të çmuara për të vlerësuar protagonistin kryesor, princ, mbret, dozh, funksionar, fisnik apo aleat, dhe jepeshin ose me ceremoni pritjeje, ose pasandaj shoqëronin kredencialet apo ndihmat materiale e financiare që dërgoheshin.

Në rastin konkret, nuk mund të përjashtohet hipoteza se dy medaljonet e para me portretin e Skënderbeut mund të jenë porositur nga Alfonsi i Aragonës te Pisanello, i cili në vitet e fundit të jetës, me një përvojë të shkëlqyer si piktor, medaljon-punues dhe miniaturist kodikësh, ndodhej pikërisht në Napoli më 1448-1451, periudha kur pas Traktatit të Paqes me Venedikun (v.1448), Skënderbeu do arrinte fitoren historike ndaj turqve pas rrethimit të parë të Krujës (v.1450).

Prof. Lutfi Alia, mbështetur tek studiuesi i njohur venecian Piero Voltolina, i bën një prezantim dhe trajtim shkencor tre medaljoneve me portretin e Skënderbeut që ndodhen në katalogun voluminoz të Voltolina-s “Storia della Repubblica di Venezia attraverso le medaglie” (Milano, 1988). Bëhet fjalë për të njëjtat medaljone të derdhura, por studiuesi venecian e shtyn me një dhjetëvjeçar datën e prodhimit të tyre, realizuar, sipas tij, më 1463 në Venecie dhe më 1465 në Romë. Prof. Alia, duke iu referuar edhe studiuesit Frederick Kenner (Vjenë 1898), është i mendimit se gravurimi i portretit të Skënderbeut (me autor anonim, në këtë rast), duhet të jetë bërë mbi bazën e skicimeve të G. Bellini-t më 1461, konkretisht kur Skënderbeu ishte i ftuar nga Papa Piu II në dasmën e Antonio Piccolomini, ose pastaj më 1463, kur Gjergj Kastrioti, thekson ai, “vizitoi Venecian për të marrë pjesë në ceremoninë e shpalljes “Qytetar Nderi i Veneto-s””.

Po prapë, se ku, kur dhe në ç’rrethana Bellini e ka skicuar Skënderbeun, në Napoli, Romë, Venedik apo Lagunova, kjo është një çështje që mbetet e hapur



për hulumtim e studim të dokumentuar. Megjithatë, të gjithë studiuesit, shqiptarë e të huaj, që janë marrë me portretet më të hershme të Heroit tonë Kombëtar, që nga A. Thevet e P. Giovio (shek. XVI), që nga F. Kenner e De Martino (shek. XIX), tek F. Konica, F. Noli, V. Malaj, Dh. Dharmo, K. Frashëri, K. Biçoku, F. Hudhri, M. Ahmeti, K. Naska, P. Voltolina, L. Nadin, I. S. Karanxha e L. Alia, të tërë janë në një zë kur pohojnë se portreti më i hershëm i Skënderbeut duhet të jetë realizuar nga Bellini (1429-1507) “d’après nature”, mbi bazë skicimesh (sot të humbur) gjatë vizitës/vizitave të Kastriotit të Madh në Itali. Pra, modeli, lënda e parë e gjallë, ka qenë e pranishme, para syve dhe penelit të Bellini-t. Mirëpo, nuk përjashtohet mundësia që Heroi të jetë skicuar më parë edhe nga Bellini Ati (Jacopo).

Nga ana tjetër, mbetet e hapur për dokumentim shkencor edhe çështja nëse janë apo nuk janë të viteve 1449-1451 medaljonet e para që i njihen Pisanello-s. Sepse me të drejtë mund të shtrojmë pyetjen: përderisa gjer më sot nuk është dokumentuar që Skënderbeu të ketë qenë në këto vite në Itali, mbi çfarë baze modeli janë realizuar ai/ato portrete? Vërtet, nuk përjashtohet mundësia që të jenë bërë skicime të portretit të Skënderbeut edhe gjatë kësaj periudhe, brenda vendit apo në Raguzë e gjetkë, dhe më pas, këto skicime të jenë dërguar në Itali (gjatë vajitje-ardhjeve të ambasadorëve) për të përfunduar te Pisanello si porosi “nga lart” (nga kushdo që financonte) për të përgatitur dhuratën e veçantë, në rastin konkret medaljonet. Për më tepër që gjesti dhurues merr kuptim të madh gjatë kësaj periudhe, kur Gjergj Kastrioti njihet tashmë si “Zot i Arbrit” dhe bashkëpunonte suksesshëm me Vatikanin, Janosh Huniadin dhe Alfonsin e Aragonës, kur kishte prapsur mbi njëzet sulme osmane dhe Kruja me qytetet e tjera të Arbërisë u bënë ballë rrethimeve të njëpasnjëshme, dhe sidomos kur ishte nënshkruar Traktati i Gaetës (mars 1451). Mbi të gjitha, pikërisht gjatë këtyre viteve datojnë edhe dy kodikët e famshëm me emblemën kastroiotase që kanë qenë drejtpërdrejt në zotërim të Kastriotit të Madh: “Libri i Uratave” dhe “Libri i Petrarkës” (prezantimin e këtyre kodikëve e kemi bërë te monografia “F. Andrea, D. Muka, “Tre libra të bibliotekës kastroiotase në përfaqje me heraldikën shqiptare”, Studia Albanica, 2007”.

Më tej, sikurse pohon me të drejtë edhe prof. L. Alia në studimin “Skënderbeu në Artet figurative të shek. XV”, mbetet po ashtu e hapur çështja se gjatë shek. XV duhet të ketë pasur edhe vepra të tjera me portretin origjinal të Skënderbeut. Një portret i tillë i Skënderbeut është kataloguar për

shembull nga “The Athenaeum-a journal of literature, NR3066, 31 july 1886, f. 130”, ku vihet në dukje: “Portret i Skënderbeut nga Alesso Baldovinetti” (1425-1499), bashkëkohës ky i G. Bellini-t dhe A. Pisano-s. Album-Antologjia jonë “Skënderbeu-Heroi Kombëtar i shqiptarëve, 1413-2017”, konkretisht “Pjesa shtojcë- Katalogu” dëshmon për mjaft vepra në këtë drejtim, “të inventarizuara në kartë”, të themi, por të humbura apo ende të pazbuluara.

Duke u shkëputur nga medaljonet e para me portretin e Skënderbeut, realizuar gjatë kohës kur vetë Heroi ishte gjallë (a nuk na kanë ardhur historikisht që nga Lashtësia portretet më të hershme të mbretërve dhe të figurave të shquara fillimisht nëpërmjet monedhave e medaljoneve ?!), le ta themi pa drojë se sot kemi-gjithnjë duke iu referuar viteve 1460 dhe për aq sa na lejon njohja e derisotme-edhe portretin më të parë, më të hershëm e më origjinal të Skënderbeut, fatmirësisht me ngjyra, ndonëse në miniaturë.

Është fjala për portretin e Skënderbeut në kodikun “De Romanorum Magistratibus” të Andrea Domenico Fiocco-s, Romë 1465, që ndodhet sot në Bibliotekën e Universitetit të Harvardit, Houghton Library, Cambridge Mass. me numër rendor MS Typ 496. Studimin më të plotë për këtë portret, më të argumentuar shkencërisht, me të dhëna të sakta dhe referime të shumta ia ka bërë të njohur kohët e fundit publikut shqiptar studiuesi pasionant Ilija S. Karanxha, i cili ka hedhur tanimë teza të guximshme për historiografinë shqiptare të periudhës skënderbejeane. Me të drejtë, Karanxha nënvizon në studimin e tij “Skënderbeu autentik dhe modeli i Romës antike” (“Zemra Shqiptare”, nëntor 2014), lidhjen organike të këtij portreti të Heroit jo vetëm me portretet e tij në medaljone, por edhe me portretin e Skënderbeut të Barleti, e më tej me portretin mbi portën kryesore të Pallatit të Skënderbeut në Romë.

Sinjalin e parë të pranisë së këtij portreti e dha prof. Shaban Sinani kur e botoi atë me cilësi shumë të dobët (fotokopje) në veprën e tij “Beratinus” (Argeta LMG, Tiranë, 2004). Më 2005, Prof. Kaliopi Naska botoi në “Revista Ushtarake” shkrimin “Si u gjet thesari i Drishtit?”, ku vinte në dukje për herë të parë praninë e kodikut “De Romanorum Magistratibus” si dhe dy ilustrimet e këtij kodiku, njëri prej të cilëve, siç theksonte ajo me të drejtë, “... portreti më i hershëm i njohur gjer më sot i Gjergj Kastriotit”.

Më pas, në maj 2007, antikuari Dritan Muka në Kanada më dërgoi me e-mail historikun e shijës së këtij kodiku si dhe përshtkrimin e tij të hollësishëm sipas katalogut “Rare books and early mss, bot. Davies &

Orioli, London, 1962”. Por u desh, disa vite më pas, pena e studiuesit Karanxha për të dhënë të plotë tablonë sinoptike të portretit origjinal të Heroit tonë kombëtar, si dhe përqasjen e tij me krejt portretet më të hershme të Skënderbeut që njihen deri më sot.

Mund të shtrojmë me të drejtë pyetjen: po përse ky portret origjinal i Skënderbeut në këtë kodik të titulluar “De Romanorum Magistratibus, Roma, 1465”, që shqip do ta përkthenim “Magjistërit romakë” apo më thjesht “E drejta Romake”? Në çfarë rrethanash duhet të jetë realizuar, dhe përse? Të dhënat flasin se humanisti dhe jurist-konsulli italian Andrea Domenicco Fiocco (147?-1452-që mbante në atë kohë si pseudonim edhe emrin e historianit romak Lucio Fenestella, të kohës së Tiberit) duhet ta ketë shkruar veprën e tij të famshme “De Romanorum Magistratibus” rreth vitit 1427, koha kur ai ishte kanonik i Firencës. Kjo veprë e shkëlqyer e Rilindjes italiane ishte një risi, stoli, thesar, që u kopjua me dorë nga skribë të njohur shumë herë dhe shumë më përpara shpikjes së Gutenbergut, veprë që do vazhdon të kopjohej si kodik, i pjesshëm a i plotë, deri në vitet 1490. Fakti që ekzemplari “De Romanorum Magistratibus” i vitit 1465 përmban dy ilustrime mjaft domethënëse me tematikë arbërore (çelet me miniaturën e një prifti dominikan që i dhuron -e nënvizojmë këtë fjalë për të mos thënë i dorëzon-kodikun një princi shqiptar dhe mbyllet me më të famshmin e më të parin portret të Skënderbeut) vetë ky fakt na jep neve sot të drejtën të parashtrimeve tezen tonë se vepra e Fiocco-s duhet t’i jetë bërë dhuratë drejtpërdrejt Skënderbeut në emër të Vatikanit gjatë vizitës së tij po atë vit në Romë. E mbështesim nga ana tjetër këtë tezë tonën edhe me faktin se tashmë tre kodikë të tjerë me emblemë kastroiotase i ishin bërë dhuratë Skënderbeut (në vitet 1450-1465) qoftë nga Alfonsi e Ferdinandi i Aragonës, qoftë nga Vatikani, dhe konkretisht “Libri i Uratave”, “Libri i Petrarkës” dhe “Libri i Skënderbeut”, ky i fundit një lloj enciklopedie e kohës. Pra, për mendimin tonë, “De Romanorum Magistratibus-1465” i Fiocco-s, me portretin origjinal të Skënderbeut ka qenë kështu kodiku i katërt i “Bibliotekës Kastroiotase”, në pronësi të drejtpërdrejt të Familjes Kastrioti në Krujë për aq kohë sa ishte gjallë vetë Heroi Kombëtar. Më pas, këto libra të çmuar për kohën dhe për personin që i zotëronte, krejt kancelaria kastroiotase, objektet më me vlerë të Heroit, nga shpatat (dhe jo një, por shumë!), deri të përkrenarja, u morën dhe u mbartën të gjitha në Itali me anije të posaçme (ndoshta dhe vetë trupi i Heroit) nga Donika Kastrioti për t’i pasur pranë vetes si thesare dhe si trashëgimi për të birin dhe pasuesit e tij, e mbi të gjitha si dëshmi historike të çmuara për Bëmat e KryeHeroit shqiptar. A nuk ndodhi kështu edhe me “Zojën e Këshillit të Mirë”, ikonën shpirtërore dhe partonen e gjithë Arbërisë dhe të arbërve?

Në fakt, nuk është se kundërshtojmë këtu tezën e Karanxhës, sipas së cilës “De Romanorum Magistratibus-1465”, me portretin e Skënderbeut, duhet të ketë qenë në pronësi të Raffaele Maffei Voterano-s dhe që këtë krejt arsyetimi i tij i drejtë për lidhjen organike të portretit të Skënderbeut me grafikën e veprës së Barleti-Beçikemit “De Vita et Gestis Scnderbegi”. E pranojmë tezën e tij deri në këtë pikë, por jo më tej. Nuk besojmë, në një fjalë, që ky kodik të ketë qenë më herët (pas vitit 1465) në pronësi të Gherardo di Maffei-t (i ati i Raffaele-s), në nderim të fisnikërisë së tij. Madje, vetë Karanxha e vë në pikëpyetje këtë tezë duke pohuar konkretisht: “Hulum-

timin në këtë pikë mund ta konsiderojmë akoma të hapur” (!) Sigurisht, në këtë mes, siç pohon edhe ai, kanë dorë-për gjithë sa rrodhi më pas në Itali me objektet e Heroit, Pjetër Engjëlli e Ferrante Kastrioti që jetonin dhe vepronin mes parisë dhe fisnikërisë së Napolit.

Nga ana tjetër, dëshmia e André Thevet, kozmografi i mbretit të Francës, që ka vizituar Ballkanin në mesin e shek. XVI dhe ka gjetur portret origjinal të Skënderbeut mes shqiptarëve në Butola (apo Bitola, emri i hershëm i Manastirit) të Arbërisë është domethënëse për faktin që portretet e Skënderbeut kishin filluar të përhapeshin në masë përtej Italisë, për mbajtjen gjallë të kujtimit të Heroit, sidomos në mbarë trevat arbërore. E dëshmon po ashtu edhe portreti i Skënderbeut (ndoshta nga Bellini) që ka qenë ruajtur historikisht nga familja Curani në Shkodër, si dhe ish koleksioni i famshëm i kardinal Albanit në Romë, që mbante mjaft portrete të Skënderbeut të shek. XVI me autorë anonimë, dhe sidomos portrete po të Skënderbeut të stilit tashmë “të fantazuar” me autorësi emrash të mëdhenj të Rilindjes Europiane, që nga Antonio Pallaiulo e Giorgione, deri te Guercino, Ticiani, Rembrandt, të cilët do pasoheshin gjatë Rilindjes shqiptare nga Theohar Gjini për një portret psikologjik të Skënderbeut. Vetë shpërbërja e koleksionit të kardinal Albanit pas vdekjes së tij, me shitjet private që u bënë, do të ishte një shtysë e re e mëtejshme për përhapjen dhe shumëfishimin e portreteve të Skënderbeut në krejt Europën.

Po ashtu, portreti i njohur i Skënderbeut nga Christofano dell’Altissimo në Muzeun Uffizi (mbi bazën e origjinalit të Bellini-t), do shndërrohej që herët mes shqiptarëve, brenda dhe jashtë vendit, si portreti më shpirtëror e popullor i Heroit Legjendar, duke u vënë sidomos në qendër të Rilindjes shqiptare, të studimeve, publikimeve dhe arteve grafike. Kjo edhe për faktin se ky portret përmban, sikurse theksojnë M. Zeqo, L. Alia dhe mjaft studiues, vrragjen (plagën) në tëmtë të Skënderbeut marrë në betejë rreth moshës 60 vjeçare, në bazë të dëshmisë historike të Barletit.

Sigurisht tonin në shtimin e portreteve të Skënderbeut, më të hershme dhe më pranë origjinaleve të Bellini-t dhe shokëve të tij e dhanë që pas vdekjes së Heroit piktorët e shquar italianë të shek. XVI, sidomos Bernadinus Vitalibus, të cilët shpejt do pasoheshin nga ilustratorët francezë e sidomos ata gjermanë, zviceranë e flamandë, nga Jorg Breu, Ati dhe i Biri, te Hans Schaufelein, Jost Amann, Tobias Stimmer, Domenicus Custos, pasuar nga J. Pontanus, De Bry, P.C. Balhasar, etj. Shekujt XVI-XVII dëshmuar për një vlerë e famë gjithnjë në rritje të Kastriotit të Madh, duke e shndërruar KryeTrimin shqiptar në simbol qëndrese të paepur përpara superfuqisë së kohës që përfaqësonte Perandoria osmane, përpara rrezikut të saj iminent kërcënues, ku ndodhej Italia dhe mbarë Europa. Krahas përkthimit në shumë gjuhë europiane të Barletit mbi bazën e “Historisë së Skënderbeut” të frëngut Jacques de Lavardin, krahas shtimit të monografive për Heroin shqiptar, kërkohet tanimë, dhe u arrit me sukses, dhe për një kohë të gjatë e në vazhdim, që Heroi shqiptar të paraqitej Epokal, Burrë shteti i madh, Luftëtar i paepur, Mbrojtës i Krishtërit, siç kishte qenë në të gjallë të tij me vetë titullin “Atlet i Krishtit” që mbajti gjer në fund me nderin e Shqiptarit të Madh e të KryeHeroit, me nderin e “Babait të Kombit”, siç e ka quajtur Faik Konica.



FORCA TOKËSORE DHE KOMANDA MBËSHTETËSE

Përmbytjet: 445 trupa dhe 143 mjete të angazhuara në terren

Që prej datës 8 janar efektivë dhe mjete të Forcës Tokësore dhe Komandës Mbështetëse vazhdojnë të jenë të angazhuar në zonat e prekura nga përmbytjet e shkaktuara nga reshjet e dendura që vijnë të bien. Më konkretisht Forcat e Armatosura po operojnë në: Bajram Curr, Shkodër, Lezhë, Pukë, Tiranë, Durrës, Elbasan, Fier, Korçë dhe Vlorë ku në total janë angazhuar 445 trupa dhe 143 mjete. Përveç trupave të angazhuara drejtpërdrejt në operacion, trupa të tjera qëndrojnë në gatishmëri në reparte për t'iu përgjigjur çdo situatë. Strukturat e Forcave të Armatosura vazhdojnë të mbajnë nën monitorim të vazhdueshëm situatën, në bashkëpunim të ngushtë me pushtetin vendor dhe me Agjencinë Kombëtare të Mbrojtjes Civile me qëllim marrjen e masave të nevojshme në kohën më të shkurtër dhe eliminimin e pasojave të mundshme. Angazhimi i Forcave të Armatosura do të vazhdojë deri në rikthimin në normalitet të situatës.

